1140
48/1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE DHE PËRPUTHSHMËRISË PËR ARSIMIN, SPORTIN DHE RININË
DREJTORIA E PROGRAMIMIT, STANDARTIZIMIT DHE HARMONIZIMIT TË KUADRIT RREGULLATOR

Nr. 2446/1 Prot. Tiranë, më 23.03.2018

Lënda: Kthim përgjigje

Z. Dorian Matlija
Drejtor Ekzekutiv
Qendrës "Res Publika"
Bulevardi "Gjergj Fishta", Nd.24, H.3, Ap.44
Tiranë

Në përgjigje të shkresës suaj nr. prot. 48/18, "Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion të dokumentacionit", protokolluar në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë me numër 2446, datë 05.03.2018, mbështetur në ligjin nr. 119, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit", ju përcjellim bashkëlidhur kopje të urdhrit të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë me nr. 489, datë 18.12.2015 "Për përbërjen e Këshillit të Arsimit të lartë dhe Kërkimit Shkencor (KALSH), si dhe urdhrin nr. 490, datë 7.10.2016 " Për një ndryshim në urdhrin nr. 489, datë 18.12.2015 "Për përbërjen e Këshillit të Arsimit të lartë dhe Kërkimit Shkencor (KALSH). Aktet nënligjore kanë të përcaktuar edhe listën e anëtarëve të Këshillit të Arsimit të lartë dhe Kërkimit Shkencor.

Ju informojmë se vendimi për caktimin e tarifave të studimit në arsimin e lartë është në proces dhe ende nuk është miratuar.

Lidhur me kërkesën tuaj për memorandumin ndërmjet MASR dhe AADF për programin e kualifikimit të drejtuesve të shkollave, ju informojmë se nuk ka të nënshkruar ndonjë memorandum lidhur me këtë çështje.

Duke ju falënderuar,

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
Koli Bele

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË TIRANË

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 23, AL 1001, Tiranë
Web site: www.arsimi.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
MINISTRI

Nr. 11167 Prot. Tiranë, më 18.12.2015

URDHËR

Nr. 489, datë 18.12.2015

PËR

PËRBËRJEN E KËSHILLIT TË ARSIMIT TË LARTË DHE KËRKIMIT SHKENCOR (KALKSH)

Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 2 të nenit 8, të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet shqiptare të arsimit të lartë", Vendimit nr. 989, datë 9.12.2015 të Këshillit të Ministrave "Për organizimin, funksionimin, koherencën e qëndrimit në detyrë dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor (KALKSH)",

URDHËROJ:

1. Emërimin e 12 (dymbëdhjetë) anëtarëve në përbërje të Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, personalitete të njohura të fushave akademike, si më poshtë:

a)	Arjan Gjonça	Anëtar;
b)	Adrian Civici	Anëtar;
c)	Aleksandër Xhuvani	Anëtar;
d)	Anila Paparisto	Anëtar;
e)	Artan Hoxha	Anëtar;
f)	Besnik Aliaj	Anëtar;
g)	Edmond Hadëri	Anëtar;
h)	Elida Rapti	Anëtar;
i)	Erviн Demo	Anëtar;
j)	Myftar Barbullushi	Anëtar;
k)	Ali Panda	Anëtar;
l)	Marjana Semini	Anëtar;

2. Anëtarët e mësipërm të Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, emërohen për një periudhë një vjeçare, e cila fillon me hyrjen në fuqi të këtij urdhëri.

3. Me qëllim realizimin e misionit të Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor anëtarët e mësipërm do të jenë dhe pjesë e komisioneve të përhershme apo të përkohshme

Nr. 23, AL-1001, Tiranë
Tel: +355 4 2222260 Fax: +355 4 2232002
Web site: www.arsimi.gov.al.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
MINISTRI

Nr. 9964 prot Tiranë, më 07.10.2016

URDHËR

Nr. 490, datë 7.10.2016

PËR

NJË NDRYSHIM NË URDHËRIN NR. 489, DATË 18.12.2015 "PËR PËRBËRJEN E KËSHILLIT TË ARSIMIT TË LARTË DHE KËRKIMIT SHKENCOR (KALKSH)"

Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 2 të nenit 8, të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet shqiptare të arsimit të lartë", Vendimit nr. 989, datë 09.12.2015 të Këshillit të Ministrave "Për organizimin, funksionimin, koordinimin e qëndrimit në detyrë dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor (KALKSH)",

URDHËROJ:

1. Në urdhërin nr. 489, datë 18.12.2015, germa "a" e pikës 1, ndryshon si më poshtë:
   "a) Fatos Tarifa Anëtar;"

2. Koordinatja e emërimit sipas këtij urdhëri, përfundon së bashku me afatin e anëtarëve të tjerë të Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor (KALKSH).

3. Ngarkohet Sekretariati Teknik i Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor (KALKSH), për njoftimin e këtij urdhëri, anëtarit përkatës.

4. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës dhe Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT TIRANË

Nr. 23, Al. [illegible], Tiranë
Tel: +355 4 [illegible], Fax: +355 4 2232002
Web site: www.arsimi.gov.al.al